



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 57, Datë 20.02.2026

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS
KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 6/10/20/35 kV PËR VITIN
2026**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 678/2 prot., datë 18.02.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë ujësjellës kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV për vitin 2026” dhe informacionin shtesë me nr. 678/4 prot., datë 19.02.2026 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe shoqëritë ujësjellës kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV për vitin 2026”,

Konstatoi se:

- Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime gëzojnë status të veçantë në kuptim të nenit 8, pikat 1 dhe 2, të VKM-së nr. 456/2022, e ndryshuar, si subjekte që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe që, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik, përfitojnë furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Në zbatim të kësaj dispozite, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka detyrimin të garantojë pa ndërprerje furnizimin me energji elektrike për këto subjekte, ndërsa edhe në rast se ato kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, u sigurohet vazhdimësia e furnizimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.
- KESH sh.a. me datë 18.02.2026 dërgoi në ERE “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr.1212/1 prot., datë 06.02.2026 për vitin 2026”, i cili përcakton çmimin mesatar të shitjes së energjisë për sasinë e kontraktuar për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV (prej 5.70 lekë/kWh), për vitin 2026.
- FSHU sh.a. me shkresën me nr. 678/3 prot., datë 19.02.2026, përcolli në ERE aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2026 për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të lidhur në nivelin e tensionit 6/10/20 kV si dhe për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, bashkëlidhur

të cilit gjendej dhe “Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a, nr.1212/1 prot., datë 06.02.2026”.

- Komponentët e përdorur për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:
 - **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime të lidhura në nivelin 6/10/20/35 kV edhe për vitin 2026 do të vijojë të jetë 5.70 lekë/kWh, bazuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr.1212/1 prot., datë 06.02.2026 të KESH sh.a.
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 Janar 2025-31 Dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 - 31 dhjetor 2027” prej **0.85 lekë/kWh**.
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV** në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”, **është 3.99 lekë** për nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe **1.55 lekë/kWh** për nivelin e tensionit 35 kV.
 - **Kostot administrative, të cilat vijnë të jenë 1.06 lekë/kWh.**
 - **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën **0.17 lekë/kWh** për kategorinë Ujësjiellës Kanalizime.
 - Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” dhe të dhënave në dispozicion në përllogaritjet e kryera nga ERE rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit për vitin 2026, për shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime 6/10/20/35 kV paraqitet në tabelën në vijim:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime për vitin 2026			
Viti 2026		Nivelet e tensionit	
		35 kV	20/10/6 kV
	Njësia	Çmimi	Çmimi
ÇBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	5.70	5.70
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3 %)	Lekë/kWh	0.17	0.17
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = ÇBEt + Pr * ÇBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	9.33	11.77

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 9.33 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 11.77 lekë/kWh për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.
3. Çdo ndryshim në elementët përbërës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI